



24/08/2021

Tiranë – Kapet dhe arrestohet një shtetas që mbante armë zjarri me vete

Vijojnë kontrollet e pandërprera për kapjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri me vete apo që janë të shpallur në kërkim.

Si rezultat i kontrolleve kapet në një lokal, një 48-vjeçar që mbante armë zjarri me vete. Në pranga dhe një tjetër shtetas, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”. Sekuestrohet një armë zjarri dhe municion luftarak.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, në bazë të informacione se në ambientet e një lokali në lagjen “Ali Demi”, ndodhej një shtetas i cili mbante armë zjarri me vete, kanë organizuar punën dhe kanë bërë kapjen dhe arrestimin në flagrancë të shtetasit F. P., 48 vjeç.

Gjatë kontrollit të ushtruar në tavolinën ku po qëndronte ky shtetas, u gjet dhe u sekuestrua një armë zjarri dhe një krehër me 5 fishekë. Në vijim të veprimeve u arrestua në flagrancë edhe shtetasi B. Gj., 47 vjeç, pasi kishte dijeni për armën, por nuk ka treguar.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale “Armëmbajtja pa leje” dhe “Moskallëzimi i krimit”.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Qështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

Share

Share

Share

Share

Email

◀ Durrës – Vihen në prangat e Policisë 3 shtetas, për vepra të ndryshme penale

Vlorë – Policia parandalon një ngjarje kriminale në familje. Ndërhyrja në kohë dhe me profesionalizëm e shërbimeve të Policisë Vlorë parandaloi përshkallëzimin e mëtejshëm të ngjarjes ▶